



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

**RREGULLORE
PËR
VLERËSIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË KLIENTIT**

Miratur me Vendimin e Bordit nr. 197, datë 29.12.2020

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës së vlerësimit të përshtatshmërisë së klientit duke përdorur formate standarde të pyetësorit të përshtatshmërisë, nëpërmjet të cilave shoqëria komisionere/banka që ofron shërbime investimesh siguron informacionin e nevojshëm për të vlerësuar përshtatshmërinë e klientit me instrumentin financiar apo shërbimin e investimit të ofruar/kërkuar.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 64, pika 2 dhe nenit 65 të Ligjit nr.62/2020, datë 14.5.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

**Neni 3
Përkufizime**

1. Në këtë rregullore termi:

“Ndërmjetës financiar” është shoqëria komisionere apo banka, e licencuar/regjistruar/njohur për të kryer shërbimin e nënshkrimit, hedhjes në treg dhe/ose rishitjen e instrumenteve financiare.

2. Të gjitha përkufizimet e tjera të kësaj rregulloreje janë të njëjta me ato të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” të referuar në këtë rregullore si “Ligji”.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet nga shoqëria komisionere/banka që ofron shërbime investimesh (shkurt banka), e cila para se të ofrojë shërbime investimi duhet të marrë informacionin e nevojshëm për çdo klient ekzistues ose të mundshëm në fushën e investimeve, të dokumentuar nëpërmjet plotësimit nga klienti të pyetësorit standard, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Testi i Përshtatshmërisë

1. Shoqëria komisionere/Banka dokumenton përshtatshmërinë e klientit nëpërmjet testit të përshtatshmërisë.
2. Shoqëria komisionere/Banka ruan dokumentacionin e testit të përshtatshmërisë të klientit dhe e vë në dispozicion të Autoritetit sa herë që kërkohet.
3. Shoqëria komisionere/Banka gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave personale të klientit zbaton legjislacionin në fuqi “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 6

Përfshirja nga detyrimi për të zbatuar testin e përshtatshmërisë

1. Shoqëria komisionere/Banka nuk detyrohet të përgatisë testin e përshtatshmërisë në rastin e ofrimit të shërbimit të marrjes dhe transmetimit dhe/ose ekzekutimit të urdhrave për llogari të klientit, me ose pa shërbime ndihmëse, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) Shërbimi ka të bëjë me:
 - i. Tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë;
 - ii. Aksione të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, ku këto aksione janë aksione në shoqëri tregtare, duke përfshirë aksionet në sipërmarrjet e

- investimeve kolektive, të cilat nuk janë sipërmarrje të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, dhe aksionet që përmbajnë në strukturën e tyre një instrument derivativ;
- iii. Obligacione ose forma të tjera të borxhit të titullzuar ose obligacione të garantuara të listuara dhe pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, duke përjashtuar ato obligacione ose borxhe të konvertueshme në tituj/obligacione të nënrenditura, apo që përfshijnë një instrument derivativ ose kanë një strukturë, e cila e bën të vështirë kuptimin e instrumentit nga ana e klientit;
 - iv. Instrumente të tregut të parasë, duke përjashtuar ato instrumente, të cilat përmbajnë një derivativ ose kanë një strukturë që e bën të vështirë kuptimin e instrumentit nga ana e klientit;
 - v. Kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, të cilat janë sipërmarrje të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, si dhe kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të cilat investojnë pjesën më të madhe të aktiveve të tyre në instrumente që përjashtohen sipas kësaj rregulloreje.
- b) Shërbimi ofrohet me nismën e klientit ekzistues ose të mundshëm, kur klienti ka kërkuar në mënyrë specifike që të mos i jepen këshilla;
 - c) Klienti ekzistues ose i mundshëm është paralajmëruar në mënyrë të qartë se gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve shoqërisë komisionere/bankës nuk i kërkohet të vlerësojë nëse instrumenti ose shërbimi i dhënë ose i ofruar është i përshtatshëm për klientin dhe për këtë arsye klienti nuk përfiton nga mbrojtja përkatëse e rregullave të ushtrimit të veprimtarisë;
 - d) Informacioni i plotë për karakteristikat e një instrumenti financiar është në dispozicion të publikut dhe rrjedhimisht një klient joprofesionist është i aftë të marrë një vendim të mirinformuar për kryerjen e një transaksioni me instrumentin në fjalë.

Neni 7

Përshtatshmëria sipas llojit të shërbimit dhe kategorisë së klientit

1. Dhënia e rekomandimeve ose këshillimi për shërbimet e investimit dhe instrumentet financiare, apo aktiviteti i administrimit të portofolit nga shoqëria komisionere/banka për klientin joprofesionist, bëhet në përputhje me profilin e klientit pas vlerësimit të përshtatshmërisë së klientit sipas informacionit të marrë, duke përdorur pyetësin standard sipas aneksit 1 të kësaj rregulloreje. Për një vlerësim më të plotë të profilit të klientit, shoqëria komisionere/banka mund të gjykojë të arsyeshme zgjerimin e kërkesave për informacion përtej pyetësit standard.
2. Në rastin kur dhënia e rekomandimeve ose këshillimi për shërbimet e investimit dhe instrumentet financiare, apo aktiviteti i administrimit të portofolit bëhet për palën e

pranueshme, klientin profesionist dhe klientin e kualifikuar, shoqëria komisionere/banka nuk është e detyruar të marrë informacion në lidhje me njohurinë dhe gjendjen financiare të tyre.

3. Në rastin kur ofron shërbimin e marrjes, transmetimit dhe ekzekutimit të urdhrave për klientin joprofesionist (klienti nuk merr këshilla apo rekomandime ose shoqëria nuk vepron në cilësinë e administratorit të portofolit), apo shërbimin si ndërmjetës financiar, shoqëria përgatit pyetësoin për vlerësimin e përshtatshmërisë sipas rregullave të miratuara nga organet drejtuese të saj. Në hartimin e vlerësimit të pyetësorit të përshtatshmërisë, shoqëria mund të orientohet nga pyetjet e paraqitura në aneksin 2 të kësaj rregulloreje, si dhe duke përfshirë pyetje që lidhen me llojin specifik të produktit. Nëpërmjet informacionit të siguruar në këtë rast për klientin, shoqëria vlerëson nëse shërbimi dhe instrumenti financiar është i përshtatshëm për klientin.
4. Kërkesat e pikës 3 të këtij neni zbatohen edhe në rastin e emetimit të titujve nëpërmjet ndërmjetësit financiar ose nga vetë emetuesi, kur këto tituj klasifikohen si instrumente komplekse.
5. Në lidhje me pikën 4 instrumente komplekse do të konsiderohen:
 - a) Të gjitha llojet e instrumenteve derivative me kushtin që këto të jenë të transferueshme;
 - b) Obligacione të nënrenditura (borxh i varur) ose instrumente të tjera, subjekt i procedurës së rikapitalizimit nga brenda për zhvlerësimin dhe konvertimin e tij në aksione, në zbatim të ligjit në fuqi “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”;
 - c) Produktet e strukturuara;
 - d) Kontratat për diferencë;
 - e) Instrumente të tjera, që kanë një strukturë komplekse dhe të vështirë për t’u kuptuar nga ana e klientit.

Neni 8

Informimi i klientit

1. Shoqëria komisionere/Banka informon paraprakisht klientët e saj në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për:
 - a) Qëllimin e kryerjes së vlerësimit të përshtatshmërisë, si mjet për të vepruar në interesin më të mirë të klientit;
 - b) Detyrimin dhe përgjegjësinë për të kryer vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit;
 - c) Rëndësinë që informacioni të jetë i përditësuar, i saktë dhe i plotë.
2. Shoqëria harton procedurën për mënyrën e informimit të klientit.

Neni 9
Elementët bazë të vlerësimit të përshtatshmërisë së klientit

1. Kur shoqëria komisionere/Banka jep rekomandime, këshillime apo kryen shërbimin e administrimit të portofolit për klientin joprofesionist, informacioni i kërkuar për të kryer vlerësimin e përshtatshmërisë duhet të përfshijë sa më poshtë:
 - a) Informacion për njohuritë dhe përvojën e klientit:
 - i. Llojet e shërbimit, transaksionet dhe investimet e rregulluara, me të cilat klienti ka përvojë;
 - ii. Natyrën, vëllimin, shpeshtësinë e transaksioneve të klientit në fushën e investimeve të rregulluara;
 - iii. Nivelin arsimor, profesionin ose punë të tjera të mëparshme të klientit.
 - b) Informacion për gjendjen financiare të klientit:
 - i. Burimin dhe shkallën e të ardhurave të rregullta të klientit;
 - ii. Pasuritë e klientit, përfshirë pasuritë likuide, investimet dhe pasuritë e paluajtshme;
 - iii. Angazhimet e rregullta financiare të klientit dhe aftësinë e tij për të përballuar humbjet.
 - c) Informacion për objektivat e investimit të klientit:
 - i. Perspektivat afatgjata të investimit të klientit;
 - ii. Preferencat e rrezikut të klientit, profilin e rrezikut dhe tolerancën ndaj rrezikut;
 - iii. Qëllimet e investimit.
2. Në rast të pamundësisë së shoqërisë komisionere/bankës për të marrë të gjithë informacionin e mjaftueshëm sipas pikës 1 të këtij neni, shoqëria refuzon t'i rekomandojë klientit produktet apo shërbimet e investimit.
3. Kur shoqëria komisionere/banka ofron shërbimin e marrjes, transmetimit dhe ekzekutimit të urdhrave për klientin joprofesionist (klienti nuk merr këshilla/rekomandime apo kur shoqëria nuk vepron në cilësinë e administratorit të portofolit), apo shërbimin si ndërmjetës financiar, ajo kërkon informacion për njohurinë dhe eksperiencën e tyre në fushën e investimeve për produktin apo shërbimin e ofruar apo të kërkuar si dhe informacion që shërben për të vlerësuar se klienti ka kuptuar natyrën e riskut specifik në lidhje me instrumentin financiar kompleks të kërkuar/ofruar.
4. Në rastet kur, bazuar në pyetësonin e vlerësimit të përshtatshmërisë, sipas pikës 3 të këtij neni, shoqëria komisionere/banka vlerëson se produkti apo shërbimi i ofruar nuk është i

përshtatshëm për klientin aktual apo të mundshëm, shoqëria komisionere/banka paralajmëron klientin me shkrim apo nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi sipas një formati standard të miratuar nga organet e saj drejtuese.

5. Në rastet kur klientët aktualë apo të mundshëm nuk pranojnë të japin informacionin e kërkuar nga shoqëria për të kryer vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre, ose në rastet kur informacioni i ofruar është i pamjaftueshëm, sipas pikës 3 të këtij neni, shoqëria komisionere/banka paralajmëron klientët se shoqëria komisionere/banka nuk mund të përcaktojë nëse produkti apo shërbimi i ofruar është i përshtatshëm për ta, sipas një formati standard të miratuar nga organet e saj drejtuese.
6. Pavarësisht pikës 4 dhe 5 të këtij neni, në çdo rast shoqëria komisionere/banka zbaton urdhrin e klientit, pasi ky i fundit konfirmon me shkrim se dëshiron të vazhdojë transaksionin, edhe pas marrjes së paralajmërimit. Nëse klienti nuk konfirmon urdhërin me shkrim pas marrjes së paralajmërimit brenda afatit kohor të përcaktuar nga shoqëria, kjo e fundit ekzekuton urdhërin.

Neni 10

Detyrimi mbi hartimin e procedurës për vlerësimin e përshtatshmërisë

Shoqëria komisionere/Banka harton procedurën për kriteret e vlerësimit të përshtatshmërisë së klientëve të saj.

Neni 11

Raporti informues i përshtatshmërisë së klientit

1. Bazuar në vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit joprofesionist, shoqëria komisionere/banka, e cila jep rekomandime ose këshilla për investime, i paraqet klientit raportin informues për rekomandimet dhe këshillat e dhëna. Ky raport sqaron se rekomandimet/këshillat përshtaten me objektivat, gjendjen financiare, njohuritë e klientit dhe tolerancën ndaj rrezikut.
2. Ky raport i cili është specifik për çdo klient duhet të shkruhet në gjuhë të qartë e të kuptueshme dhe të përmbajë minimalisht:
 - a. Arsyetimin se rekomandimet/këshillat përshtaten me objektivat, gjendjen financiare, njohuritë e klientit dhe tolerancën ndaj rrezikut;
 - b. Rreziqet që shoqërojnë rekomandimin e dhënë;
 - c. Kostot dhe tarifat për rekomandimin e dhënë;

- d. Datën dhe kohën kur është dhënë këshilla;
 - e. Informacion mbi nevojën dhe frekuencën e kryerjes së vlerësimit të përshtatshmërisë.
3. Raporti informues i njoftohet klientit me shkrim ose nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi para kryerjes së transaksionit apo lidhjes së kontratës.
 4. Raporti informues lidhur me rekomandimin e dhënë rishikohet në varësi të rishikimit të vlerësimit të përshtatshmërisë.

Neni 12

Besueshmëria e informacionit të klientit

1. Shoqëria komisionere/Banka kujdeset që informacioni i mbledhur në lidhje me klientët e tyre është i besueshëm. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në, sa vijon:
 - a. Sigurimin që klientët janë të vetëdijshëm për rëndësinë e dhënies së një informacioni të saktë dhe të përditësuar;
 - b. Sigurimin që pyetjet e përdorura në këtë proces të kuptohen nga klientët, të japin një pasqyrim të saktë të objektivave dhe nevojave të klientit;
 - c. Vigjilencën për çdo kontradiktë të rëndësishme që mund të ketë ndërmjet informacioneve të ndryshme të dhëna nga klienti dhe komunikimin me të (klientin) për të zgjidhur ndonjë mospërputhje të mundshme materiale ose ndonjë pasaktësi.

Neni 13

Përditësimi i informacionit të klientit kur ofrohet shërbimi i këshillimit/administrimit të portofolit

1. Në rastet kur shoqëria komisionere/banka ka një marrëdhënie të vazhdueshme me klientin, si rezultat i një kontrate për ofrimin e shërbimit të këshillimit ose shërbimit të administrimit të portofolit, në mënyrë që të jetë në gjendje të kryejë vlerësimin e përshtatshmërisë, shoqëria duhet të miratojë procedurat që përcaktojnë:
 - a. Cila pjesë e informacionit të mbledhur nga klienti duhet t'i nënshtrohet përditësimit dhe me çfarë frekuence;
 - b. Si duhet të bëhet përditësimi dhe çfarë veprimi duhet të ndërmerret nga shoqëria kur merren informacione shtesë ose përditësohen, ose në rastet kur klienti nuk arrin të sigurojë informacionin e kërkuar.
2. Shoqëria duhet të rishikojë rregullisht informacionin e dhënë nga klienti për të siguruar vazhdimësinë e informacionit. Për këtë qëllim, shoqëria duhet të zbatojë procedurat për të

inkurajuar klientët të përditësojnë informacionin e dhënë, sidomos në rastin e ndodhjes së ndryshimeve të rëndësishme në një apo disa nga elementët e përcaktuar në nenin 9 pikat a), b) dhe c) të kësaj rregulloreje.

3. Shoqëria komisionere/Banka ndërmerr një vlerësim periodik të paktën 1 herë në vit të përshtatshmërisë së klientit. Frekuenca e rishikimit të vlerësimit të përshtatshmërisë rritet në varësi të profilit të rrezikut të klientit dhe llojit të instrumentit financiar që po rekomandohet.
4. Shoqëria informon klientin kur informacioni shtesë i dhënë prej tij sjell ndryshim të profilit të rrezikut.
5. Përditësimi mund të bëhet gjatë takimeve periodike me klientët ose nëpërmjet dërgimit të një pyetësoi me pyetje përmes një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, për çështjet që duhet të përditësohen.

Neni 14 **Ruajtja e të dhënave**

1. Shoqëria komisionere/Banka duhet të:
 - a. Mbajë dokumentacionin në lidhje me vlerësimin e përshtatshmërisë, përfshirë këtu mbledhjen e informacionit nga klienti, çdo këshillë investimi të dhënë dhe të gjitha investimet e bëra ose jo pas vlerësimit të përshtatshmërisë;
 - b. Organizojë ruajtjen e të dhënave në mënyrë të tillë, që të ketë mundësi t'i përdorë ato lehtësisht për identifikimin e dështimeve të procesit të vlerësimit të përshtatshmërisë;
 - c. Sigurojë që të dhënat, përfshirë raportet e përshtatshmërisë të klientëve, janë të aksesueshme nga punonjësit me funksione kyçe në shoqëri dhe nga Autoriteti.
2. Ruajtja e të dhënave nga shoqëria duhet të jetë në mënyrë të tillë që të mundësojë gjurmimin e informacioneve apo shpjegimeve për investimet kryera, këshillat e dhëna për investimet apo kur këshillat nuk kanë rezultuar në investime konkrete.
3. Të dhënat e ruajtura duhet të përfshijnë:
 - a. Çdo ndryshim të bërë nga shoqëria në lidhje me vlerësimin e përshtatshmërisë, veçanërisht ndonjë ndryshim në profilin e rrezikut të investimit të klientit;
 - b. Llojet e instrumenteve financiare që i përshtaten këtij profili dhe arsyetimi për një vlerësim të tillë, si dhe çdo ndryshim dhe arsyet e tyre;
 - c. Çdo njoftim i dhënë klientit, kur shërbimi i investimit ose blerja e produktit është vlerësuar si potencialisht i papërshtatshëm për klientin;

- d. Çdo njoftim i dhënë klientit, kur klienti nuk ka siguruar informacion të mjaftueshëm për t'i mundësuar shoqërisë të ndërmarrë një vlerësim të përshtatshmërisë, nëse klienti kërkon të vazhdojë transaksionin pavarësisht këtij njoftimi dhe, kur është e aplikueshme, nëse shoqëria e pranon kërkesën e klientit për të vazhduar transaksionin.
4. Shoqëria komisionere/Banka ruan dokumentacionin e pyetësorit të vlerësimit të përshtatshmërisë së klientit për të paktën 5 vjet nga data e nënshkrimit të testit të përshtatshmërisë nga klienti.

Neni 15

Dispozita kalimtare

Të gjitha shoqëritë komisionere/bankat marrin masa për t'u përshtatur me kërkesat e kësaj rregulloreje brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Aneksi 1

Formati Standard i Pyetësorit

(Për rekomandime investimesh, këshillim, administrim portofoli)

EMRI I SHOQËRISË

Numri i Licencës së Shoqërisë Komisionere/Bankës¹

Data e plotësimit __/__/__

Ky pyetësor plotësohet përpara se t'ju jepet shërbimi. Në varësi të rezultatit të këtij pyetësori, përcaktohet profili Juaj i rrezikut, në bazë të të cilit Ju rekomandohet instrumenti financiar në përputhje me objektivat tuaja financiare, tolerancën ndaj rrezikut, situatën financiare apo njohuritë dhe eksperiencën Tuaj lidhur me investimet në instrumentet financiare. Shoqëria mund t'ju japë këshilla apo rekomandime për investime të bëra me porosi, apo të ofrojë shërbimin e administrimit të portofolit vetëm dhe ekskluzivisht nëse i përgjigjeni të gjitha pyetjeve në këtë pyetësor. Në rast se nuk i përgjigjeni të gjitha pyetjeve, pra nëse shoqëria nuk i merr të gjitha informacionet që kërkohen për një vlerësim mund të mos Ju rekomandojë apo japë këshilla investimi. Informacioni që do të na jepni nëpërmjet këtij pyetësori do të përbëjë bazën për rekomandimin tonë, prandaj është e rëndësishme të na siguron informacion të plotë, të saktë dhe të vërtetë, me qëllim që produkti/shërbimi që do Ju rekomandojmë të jenë në përputhje me objektivat e investimit Tuaj dhe profilin Tuaj të rrezikut.

Duke marrë në konsideratë faktin që profili Juaj i rrezikut mund të ndryshojë me kalimin e kohës, ne do t'Ju kërkojmë përditësimin periodik të këtij vlerësimi. Megjithatë në rast se Ju ndryshon situata Juaj financiare, sjellja Juaj ndaj riskut apo rrethana të tjera që mund të kenë ndikim në statusin e përshtatshmërisë Suaj, Ju lutem të informoni shoqërinë komisionere/bankën me qëllim që të mund të ndërmarrit menjëherë përditësimin e të dhënave Tuaja.

Kategoria e Klientit ☐ Klient i Ri ☐ Klient Ekzistues (Data e Vlerësimit të fundit: _____ Rezultati _____)	Lloji i Klientit ☐ Individ ☐ Investitor Profesionist ☐ Subjekt tregtar
Emri i Klientit (Emër, Mbiemër)	Emri i Subjektit Tregtar

¹ Shoqëria komisionere/Banka në kuadër të përgatitjes së testit të përshtatshmërisë: mbledh, ruan depoziton dhe përdor të dhënat personale të deklaruara në këtë pyetësor, në respektim të dispozitave të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

1. Të dhëna të përgjithshme

Emër Mbiemër	
Datëlindja (mosha)	
Gjendja civile	
Numri i personave në vartësi	
Numri personal (ID/pasaportë)	
Adresa e përhershme	
Shtetësia	

Arsimimi. (Niveli më i lartë i arsimimit)	☐ arsim i ulët ☐ arsim i mesëm ☐ në ekonomi ☐ Tjetër ☐ arsim i lartë ☐ arsim pasuniversitar ☐ në ekonomi ☐ Tjetër ☐ në ekonomi ☐ Tjetër
Punësimi. A keni qenë gjatë 5 viteve të fundit i punësuar në një pozicion pune që kërkon njohuri të instrumenteve dhe tregjeve financiare?	☐ po ☐ jo

2. Informacion për objektivat e investimit

2/1. Objektivi i investimit	☐ a) Menaxhim i likuiditetit afatshkurtër ☐ b) Kursime afatgjata ☐ c) Kthim të lartë edhe pse mbart rrezikun e humbjes së shumës së principalit.
------------------------------------	---

2/2. Kohëzgjatja e investimit	☐ a) Unë do të përdor pjesën më të madhe të aktiveve të mia financiare brenda vitit të ardhshëm (tërheqje nga investimet). ☐ b) Unë do të përdor pjesën më të madhe të aktiveve të mia financiare brenda 1-3 viteve. ☐ c) Unë do të përdor pjesën më të madhe të aktiveve të mia financiare pas një periudhe 3 vjeçare.
2/3. Frekuenca e investimit që dëshironi	☐ a) Disa herë në vit ☐ b) Çdo muaj ☐ c) Disa herë në muaj
2/4. Përqindja e kursimeve tuaja që dëshironi të investoni në tituj ose në instrumentet financiare të ndryshme nga depozitat me afat.	☐ a) nën 30% ☐ b) 30-50% ☐ c) mbi 50%
2/5. Gatishmëria për të ndërmarrë rreziqe.	☐ a) <u>Shkallë e ulët rreziku</u>: Unë ndërmarr vetëm rreziqe që nuk rrezikojnë principalin tim në kushtet e zakonshme të tregut, por kapitali im i investuar mund të ulet në rrethana ekstreme. ☐ b) <u>Shkallë e mesme rreziku</u>: Për të arritur një kthim më të lartë se mesatarja, unë jam gati të rrezikoj një pjesë të principalit tim. ☐ c) <u>Shkallë e lartë rreziku</u>: Duke shpresuar për kthime të larta, rrezikoj një pjesë ose të gjithë investimin tim edhe në kushte të zakonshme të tregut. Unë me vetëdije rrezikoj që në raste të pafavorshme, të jem i detyruar të paguaj shuma të mëtejshme përveç humbjes së shumës totale të investuar.
2/6. Cili portofol është zgjedhja juaj e mundshme kur normat e depozitave për të njëjtin afat janë rreth 1% ?	☐ a) Portofol i cili do të ketë një kthim konstant 1-2% në vitet e ardhshme. ☐ b) Portofol i cili do të ketë një kthim ndërmjet -2% dhe +10% në vitet e ardhshme. ☐ c) Portofol i cili pritët të ketë një kthim ndërmjet -15% dhe +30% në vitet e ardhshme dhe madje në kushte ekstreme mund të çojë në një humbje që tejkalon shumën e investuar.

3. Informacion për gjendjen financiare

3/1. Të ardhurat mujore	☐ a) nën 100,000 ALL ☐ b) ndërmjet 100,000 dhe 500,000 ALL ☐ c) mbi 500,000 ALL
3/2. Burimi i të ardhurave	☐ a) paga ☐ b) të ardhura nga aktivitete sipërmarrëse ☐ c) të ardhura nga investime financiare ☐ d) të ardhura nga pensioni ☐ e) trashëgimi ☐ f) të ardhura të tjera, specifiko _____
3/3. E gjithë pasuria juaj është: (aktive financiare, pasuri të paluajtshme, etj.)	☐ a) nën 6,000,000 ALL ☐ b) ndërmjet 6,000,000 dhe 20,000,000 ALL ☐ c) mbi 20,000,000 ALL

4. Informacion mbi eksperiencën dhe njohuritë

Shënoni me një "X" sipas rastit.

<i>Ne rekomandojmë që pyetësi të plotësohet vertikalisht për secilën dhe çdo kategori produkti.</i>		1	2	3	4	5
		Bono/obligacione të qeverisë	Obligacione të korporatave	Obligacione të nënrenditura (Borxh i varur)	Aksione	Kuota/Aksione të SIK
4/1 karakteristikat dhe rreziqet e instrumentit?	a) Unë nuk i njoh produktet.					
	b) Unë kam pak njohuri mbi karakteristikat					

	dhe rreziqet e produkteve.					
	c) Unë i njoh karakteristikat dhe rreziqet e produktit					
4/2. Ku i keni marrë njohuritë tuaja në lidhje me karakteristikat e instrumentit?	a) studime në shkollë, vetëtrajnim					
	b) përvojë e punës, përvojë e fituar përmes veprimtarive profesionale					
	c) informacion nga shoqëritë komisionere/ bankat					
4/3Sa eksperiencë keni në kryerjen e transaksioneve me këtë instrument?	a) asnjë transaksion deri në këtë datë					
	b) një vit					
	c) më shumë se një vit					
4/4. Cila është shuma mesatare e transaksioneve që ju keni kryer me këtë instrument në fund të vitit të kaluar?	a) asnjë transaksion deri në këtë datë					
	b) nën 1,500,000 ALL					
	c) mbi 1,500,000 ALL					
4/5 Rreth sa transaksione keni kryer	a) asnjë transaksion deri në këtë datë					

me këtë instrument në fund të vitit?	b) disa transaksione					
	c) kryej transaksione rregullisht					

		6	7	8	9	10	11
<i>Ne rekomandojmë që pyetësi të plotësohet vertikalisht për secilën dhe çdo kategori produkti.</i>		Kontratat e së ardhmes të tregtuara në treg të rregulluar (futures)	Kontratat e shitjes të së ardhmes me çmim të përcaktuar (forwards) në tregun mbi bankat OTC	Marrëveshjet e shkëmbimit (swaps)	Kontratat e opsioneve (options) të tregtuara në treg të rregulluar	Kontratat financiare për diferencat (CFD)	Kontrata derivativ e të mallrave (commodities)
4/1 karakteristikat dhe rreziqet e instrumentit	a) Unë nuk i njoh produktet.						
	b) Unë kam pak njohuri mbi karakteristikat dhe rreziqet e produkteve.						
	c) Unë i njoh karakteristikat dhe rreziqet e produktit						
4/2. Ku i keni marrë njohuritë tuaja në lidhje me karakteristikat e produktit? <i>(Ju lutemi, shënoni vetëm përgjigjen)</i>	a) Studime në shkollë, vetëtrajnim						
	b) Përvojë e punës, përvojë e fituar përmes veprimtarive profesionale						

<i>më specifike.)</i>	c) Informacion nga shoqëritë komisionere/ bankat						
4/3 Sa eksperiencë keni në kryerjen e transaksioneve me këtë instrument?	a) Asnjë transaksion deri në këtë datë						
	b) Një vit						
	c) Më shumë se një vit						
4/4. Cila është shuma mesatare e transaksioneve që ju keni kryer me këtë instrument në fund të vitit të kaluar?	a) Asnjë transaksion deri në këtë datë						
	b) Nën 1,500,000 ALL						
	c) Mbi 1,500,000 ALL						
4.5. Rreth sa transaksione keni kryer me këtë instrument në fund të vitit?	a) Asnjë transaksion deri në këtë datë						
	b) Disa transaksione						
	c) Kryej transaksione rregullisht						

DEKLARATA E KLIENTIT

- Deklaroj që kam kuptuar të gjitha pyetjet e pyetësorit;
- Deklaroj se të gjitha informacionet e dhëna janë të vërteta, të plota dhe të sakta. Unë e kuptoj se çdo informacion i pa vërtetë, i pasaktë ose jo i plotë i dhënë nga unë do të ndikojë në rezultatin e vlerësimit;
- Jam i vetëdijshëm që në mungesë informacioni, shoqëria nuk do të më ofrojë shërbime të këshillimit për investime dhe nuk do të jetë në gjendje të rishikojë përshtatshmërinë e instrumenteve financiare;
- Deklaroj se do të informoj shoqërinë sapo të ndodhë ndonjë ndryshim në situatën time personale ose financiare që e bën të nevojshme ndryshimin e përgjigjeve të mia.

Bazuar në rezultatet e pyetësorit tim të përshtatshmërisë (apo tonë në rast të llogarive të përbashkëta) lutem zgjidhni një prej përgjigjeve:

- Unë jam dakord me rezultatin e profilit të rrezikut të klientit dhe produktet e rekomanduara të konsideruara si të përshtatshme për këtë profil
- Unë nuk jam dakord me rezultatin e profilit të rrezikut të klientit dhe produktet e rekomanduara të konsideruara si të përshtatshme për këtë profil.

Firma e klientit

DEKLARATA E SHOQËRISË KOMISIONERE/BANKËS

Ne Ju kemi shpjeguar hollësisht qëllimin e pyetësorit të përshtatshmërisë dhe rezultatet e vlerësimit të përshtatshmërisë si dhe arësyet e rekomandimit të dhënë.

Firma

ANEKSI 2

PYETJE MBI NJOHURITË DHE EKSPERIENCËN

(Shembull orientues për rastet kur nuk ofrohet shërbimi i këshillimit/dhënies së rekomandimeve apo administrimit të portofolit në zbatim të nenit 65 të Ligjit)

Nëse Ju dëshironi të investoni në produkte/instrumente komplekse dhe Ju nuk po merrni këshillim në lidhje me këtë investim ju lutem përgjigjuni pyetjeve më poshtë duke zgjedhur PO/JO.

1. A e kuptoni që Ju nuk keni marrë këshilla apo rekomandime nga [Emri i shoqërisë/subjektit] dhe keni vendosur të investoni me vullnetin tuaj të plotë?

PO/JO

2. A i kuptoni të gjitha kostot që lidhen me investimin në këtë instrument?

PO/JO

3. A jeni i kënaqur me nivelin e rrezikut të këtij investimi dhe faktit se pavarësisht se një risk më i lartë nënkupton kthime më të larta nuk ka garanci për performancën e investimit dhe Ju mund të humbisni pjesërisht apo tërësisht shumën e investuar në këtë instrument?

PO/JO

4. A e kuptoni që performanca e kaluar e një investimi ashtu si edhe për këtë kategori instrumentesh nuk nënkupton që investimi do të ketë po të njëjtën performancë në të ardhmen?

PO/JO

5. A e kuptoni natyrën e investimit, karakteristikat e likuditetit dhe faktin që mund të mos keni mundësi të shisni [këtë produkt] nëse Ju nevojitet likuiditet?

PO/JO

- 6.** A keni investuar më përpara në tregjet e kapitalit, lokale apo ato ndërkombëtare?

PO/JO

- 7.** A jeni ndodhur përballë një situate humbje si rezultat i investimeve tuaja në instrumente financiare në të kaluarën?

PO/JO

Nëse po, Ju lutem shpjegoni situatën

- 8.** A keni investuar më përpara në këtë lloj instrumenti apo instrumente të tjera komplekse?

PO/JO

Nëse po, në cilat instrumente keni investuar.